

Ejani në kontakt me ekspertin/ten
e Strukturës me të cilin/ën bashkëpunoni, edhe nëse thjesht dyshoni se po ju ndodh ose do t'ju ndodhë një nga rastet e poshtëpërmendura.

Ose kontaktoni:



Linjë informacioni për trafikimin njerëzor
A21 –24 orë open line, greqisht, anglisht dhe
telepërkthim në 200 gjuhë.

Email: info@1109.gr



Linja telefonike SOS për dhunën ndaj grave
Sekretariati i Përgjithshëm për Politikën Familjare dhe
Barazinë Gjinore-funksion 24 orësh

Email: sos15900@isotita.gr



Linja telefonike urgjente e ndihmës sociale
Qendra Kombëtare e Solidaritetit Social-
funksion 24 orësh

Email: epikoinonia@ekka.org.gr

**Ose kontaktoni Ndërhyrjen e Shpejtë
e Menjëhershme (Άμεση Δράση):**



(Policia Greke – funksion 24 orësh)

**Trafikimi
i njerëzve - HUMAN
TRAFFICKING**



European Union
Internal Security Fund



A jeni të detyruar të punoni pa pagë ose me pagë shumë të ulët?

A ofroni shërbime seksuale pa qenë në gjendje të zgjidhni klientët tuaj, pa e mbajtur vetë ju pagën tuaj ose ta keni të pamundur të largoheni dhe keni frikë?

A jeni të detyruar të bëni gjëra që nuk dëshironi dhe keni frikë se policia do t'ju arrestojë?

Dikush ju ofroi një punë (në sektorin e bujqësisë, në industri, në punë shtëpiake, shërbimet seksuale, etj.), Ju pranuat, por si përfundim bëni një punë krejtësisht të ndryshme në kushte shumë të këqija?

A jeni të detyruar të bëni gjëra që nuk dëshironi, sepse dikush ju ka kërkuar të shlyeni një shumë të hollash?

Mos e ndjeni veten të fajësuar për situatën në të cilën ndodheni:

Autorët e trafikimit njerëzor i shtyjnë viktimat e tyre të besojnë se kanë rënë dakord dhe se janë të detyruar të bëjnë çdo gjë që u kërkohet.

Ju kurrë nuk keni rënë dakord për shfrytëzimin tuaj:

Dikush mund të përpiqet t'ju shfrytëzojë duke ju thënë se nuk keni zgjidhje tjetër veçse të punoni atje. Ju keni të drejtë të mohoni. Edhe nëse duhej të pranoni, kjo marrëveshje është e pavlefshme. Shumë herë autorët pretendojnë se ju duhet të shlyeni një shumë të madhe duke punuar për ta. Ju nuk keni një detyrim të tillë.

Shfrytëzuesit tuaj nuk janë të plotfuqishëm:

Ekzistojnë Struktura që mund t'ju mbrojnë në mënyrë që autorët të mos ju gjejnë. Nëse vendosni t'i raportoni ato në polici, parashikohen masa për mbrojtjen tuaj.



Trafikimi i njerëzve është një vepër e rëndë penale. Do të thotë që dikush po shfrytëzon dikë tjetër në mënyrë që të përfitojë duke e detyruar atë të bëjë gjëra që nuk dëshiron p.sh. të kryej shërbime seksuale, të lyp, të shesë drogë, të vjedhi ose të punojë në kushte të mjerueshme.

Nëse dikush përdor dhunë, kërcënim ose mënyra të tjera detyrimi dhe ju shtrëngon të kryeni një nga veprimet e lartpërmendura, atëherë mund të merrni mbrojtje dhe ndihmë.

Ligji mbron viktimat e trafikimit njerëzor:

Në bashkëpunim me një ekspert mund të informoheni detajisht në lidhje me të drejtat tuaja që përfshijnë strehim të sigurt, ndihmë juridike dhe procedura të parashikuara. Viktimat e tregëtisë së njerëzve kanë të drejta dhe mund të mbrohen. Ju nuk do të ndëshkoheni për veprime të paligjshme që ju kanë detyruar të bëni.